



Republika e Kosovës  
Republika Kosova  
Republic of Kosovo



**ZKA**

ZYRA KOMBËTARE E AUDITIMIT  
NACIONALNA KANCELARIJA REVIZIJE  
NATIONAL AUDIT OFFICE

# RAPORTI I AUDITIMIT PËR PASQYRAT FINANCIARE VJETORE TË FONDEVE NË MIRËBESIM PËR VITIN 2024

Prishtinë, maj 2025

# PËRMBAJTJA E RAPORTIT

- 1 Opinioni i Auditimit
- 2 Gjetjet dhe rekomandimet
- 3 Informacion i përmbledhur për planifikimin dhe realizimin e buxhetit
- 4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Shtojca I: Letër konfirmimi

Shtojca II: Shpjegim lidhur me llojet e të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA dhe pjesëve të tjera të Raportit të Auditimit

# 1 Opinioni i Auditimit

Ne kemi përfunduar auditimin e pasqyrave financiare të Fondeve në Mirëbesim për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2024, në përputhje me Ligjin për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës dhe Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Auditimi është kryer për të na mundësuar të shprehim opinionin për pasqyrat financiare dhe konkluzionin për pajtueshmërinë me autoritetet.<sup>1</sup>

## Opinion i pamodifikuar për pasqyrat financiare vjetore

Ne i kemi audituar pasqyrat financiare vjetore të Fondeve në Mirëbesim (FM), të cilat përmbajnë pasqyrën e pranimeve dhe pagesave në para të gatshme, raportin e ekzekutimit të buxhetit si dhe shënimet shpjeguese për pasqyrat financiare, përfshirë përmbledhjen e politikave të rëndësishme të kontabilitetit dhe raportet tjera<sup>2</sup>, për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2024.

Sipas opinionit tonë, Pasqyrat Financiare Vjetore të Fondeve në Mirëbesim, prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik, sipas kontabilitetit të bazuar në para të gatshme, Ligjin nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me plotësime dhe ndryshime) dhe Rregulloren MF, Nr. 01/2017 për raportim vjetor financiar nga organizatat buxhetore.

## Baza për opinion

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa e raportit 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me ONISA-P-10, SNISA 130, Kodin e Etikës së ZKA-së, si dhe kërkesat tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinion.

## Konkluzion për pajtueshmërinë

Ne kemi audituar nëse proceset dhe transaksionet përcjellëse janë në pajtueshmëri me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

Sipas mendimit tonë, përveç ndikimeve të çështjes/ve të përshkruara në seksionin Baza për Konkluzion të pajtueshmërisë, transaksionet e kryera në procesin e ekzekutimit të buxhetit Fondeve në Mirëbesim kanë qenë, në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

**Baza për konkluzion**

- B1 Te të hyrat nga qiratë kishte vonesa në arkëtimin e tyre, të cilat varionin nga një (1) muaj deri në një (1) vit, madje kishte edhe raste të tjera që nuk ishin arkëtuar që nga viti 2015 e tutje.

*Më gjerësisht shih nënkapitullin 2.1 Çështjet që ndikojnë në konkluzionin e pajtueshmërisë*

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me ONISA-P-10, SNISA 130, Kodin e Etikës së ZKA-së, si dhe kërkesat e tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA-ja është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për konkluzion.

**Përgjegjësitë e Menaxhmentit dhe të organeve drejtuese/qeverisëse për pasqyrat financiare vjetore**

Drejtori Menaxhues i Agjencisë Kosovare të Privatizimit është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të Pasqyrave Financiare sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik - Raportimi Financiar bazuar në Kontabilitetin e Parasë së Gatshme. Po ashtu, Drejtori Menaxhues i Agjencisë Kosovare të Privatizimit është përgjegjës edhe për vendosjen e kontroleve të brendshme, të cilat i përcakton si të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e Pasqyrave Financiare, pa keq deklarime materiale të shkaktuara, qoftë nga mashtrimi apo gabimi. Kjo përfshinë përmbushjen e kërkesave që burojnë nga Ligji nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë dhe Rregullorja nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar nga Organizata Buxhetore.

Drejtori Menaxhues i Agjencisë Kosovare të Privatizimit është përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Fondeve në Mirëbesim.

**Përgjegjësia e Menaxhmentit për Pajtueshmërinë**

Menaxhmenti i Fondeve në Mirëbesim është gjithashtu përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare të Fondeve në Mirëbesim në përputhje me Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësinë dhe të gjitha rregullat dhe rregulloret e tjera të zbatueshme.<sup>3</sup>

**Përgjegjësia e Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e PFV-ve**

Objektivat tona janë të ofrojmë siguri të arsyeshme nëse pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit dhe të hartojmë një raport të auditimit që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci se një auditim i kryer në përputhje me SNISA-t do të zbulojë çdo keq-deklarim material që mund të ekzistojë. Keq-deklarimet mund të vijnë nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose si tërësi, në mënyrë të arsyeshme pritet të ndikojnë në vendimet ekonomike të përdoruesve të marra në bazë të këtyre pasqyrave financiare.

Objektivi ynë është gjithashtu të shprehim një konkluzion të auditimit për pajtueshmërinë e autoriteteve përkatëse të Fondeve në Mirëbesim me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare, lidhur me subjektin e audituar.

Si pjesë e auditimit në përputhje me Ligjin për ZKA dhe SNISA-të, ne ushtrojmë gjykim dhe skepticizëm profesional gjatë gjithë auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e keq-deklarimit material të pasqyrave financiare, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që i përgjigjen atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për opinionin. Rreziku i mos zbulimit të një keq-deklarimi material që rezulton nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keq përfaqësime ose anashkalim të kontroleve të brendshme.
- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e mos-pajtueshmërisë me autoritetet, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që janë përgjegjëse ndaj atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për konkluzionin tonë për pajtueshmërinë me autoritetet. Rreziku i mos zbulimit të një rasti të mos pajtueshmërisë me autoritetet që vjen nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keq përfaqësime ose anashkalim të kontrollit të brendshëm.
- Sigurohemi ta kuptojmë kontrollin e brendshëm relevant për auditimin, për t'i hartuar procedurat e auditimit që janë të përshtatshme, por jo me qëllim të shprehjes së një opinionimi mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të Fondeve në Mirëbesim.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave të kontabilitetit të përdorura dhe arsyeshmërinë e vlerësimeve të kontabilitetit dhe shpalosjet e ndërlidhura të bëra nga menaxhmenti.
- Vlerësojmë prezantimin e përgjithshëm, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, përfshirë shpalosjet, për t'u siguruar se pasqyrat financiare paraqesin transaksionet dhe ngjarjet themelore në mënyrë të drejtë dhe të saktë.

Ndër të tjera, ne komunikojmë me menaxhmentin dhe ata që janë përgjegjës për qeverisjen edhe në lidhje me fushëveprimin dhe kohën e planifikuar të auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi domethënëse në kontrollin e brendshëm që ne e identifikojmë gjatë auditimit.

Nga çështjet e komunikuar me menaxhmentin, ne përcaktojmë ato çështje që ishin më të rëndësishme në auditimin e Pasqyrave Financiare të periudhës aktuale dhe që cilësohen si çështje kyçe të auditimit. Raporti i auditimit publikohet në ueb faqen e ZKA-së, me përjashtim të informacioneve që klasifikohen si senzitive apo për shkak të ndalesave të tjera ligjore e administrative, në pajtim me legjislacionin në fuqi.

## 2 Gjetjet dhe rekomandimet<sup>4</sup>

Gjatë auditimit, kemi vërejtur fusha për përmirësim të mundshëm, përfshirë kontrollin e brendshëm, të cilat janë paraqitur më poshtë për shqyrtimin tuaj në formë të gjetjeve dhe rekomandimeve. Këto gjetje dhe rekomandime kanë për qëllim të bëjnë korrigjimin e nevojshëm të informacionit financiar të paraqitur në pasqyrat financiare, duke përfshirë shpalosjet në formë të shënimeve shpjeguese dhe të përmirësojnë kontrollet e brendshme lidhur me raportimin financiar dhe pajtueshmërinë me autoritetet në lidhje me menaxhimin e fondeve të sektorit publik.

Ky raport ka rezultuar me katër (4) rekomandime, prej tyre tre (3) janë rekomandime të reja, dhe një (1) i përsëritur. Ne do t'i përcjellim (shqyrtojmë) këto rekomandime gjatë auditimit të vitit të ardhshëm.

Derisa për statusin e rekomandimeve të vitit paraprak dhe nivelin e zbatimit të tyre, shih kapitullin 4.

## 2.1 Çështjet që ndikojnë në konkluzionin e pajtueshmërisë

### Çështja B1 - Mos arkëtimi i të hyrave nga qiratë

#### Gjetja

Bazuar në kontratat e lidhura për qiranë midis qiradhënësit AKP/AL dhe OE për shfrytëzimin e pronave (objekte, toka) të NSH-ve në likuidim, qiramarrësi është i obliguar dhe pajtohet të paguaj shumat me pagesa brenda 5 ditëve të punës që nga pranimi i një fature. AKP mund të pajtohet me kërkesën me shkrim nga qiradhënësi për të shfrytëzuar afatet e ndonjë pagese sipas kontratës së qirasë në situatën e jashtëzakonshme dhe pajtueshmëri të tilla do të konsiderohen të vlefshme vetëm nëse për këtë pajtohet qiradhënësi.

Gjatë procesit të testimit të llogarive të arkëtueshme lidhur me të hyrat nga qiratë, kemi testuar 37 mostra. Nga këto mostra, vetëm tre (3) raste përfaqësonin qiramarrës që kishin kryer pagesat në mënyrë të rregullt ndërsa pjesa tjetër kishin obligime të papaguara, pra ishin në vonesë. Vonesat kryesisht varionin nga një (1) muaj deri në një (1) vit, përfshirë edhe borxhe më të vjetra se 1 vit. Në këtë kategori, janë identifikuar edhe borxhe të pa arkëtuara që datonin nga vitet 2015/2016 e tutje. Nga totali i mostrave të testuara, në 30 raste qiramarrësit ishin ndjekur përmes procesit të përmbarimit ose gjykatës.

Kjo kishte ndodhur për shkak të mos funksionimit të duhur të kontrolleve të brendshme dhe mos marrjes së masave për ndërprerjen e kontratave në rastet e mos pagesës. Vlen të theksohet se me datën 29 prill 2025, AKP kishte themeluar një komision për plotësim/ndryshimin e rregullores për qiradhënien e aseteve të NSH-ve, e cila deri në përfundim të auditimit ishte miratuar.

#### Ndikimi

Kjo gjendje rezulton me më pak fonde nga të hyrat dhe ulë mundësinë që të realizohen obligimet ndaj kreditorëve apo mbulimin e shpenzimeve për NSH-të që janë në proces të likuidimit.

#### Rekomandimi B1

Bordi i Drejtorëve duhet të shtojë kontrollet tek qiramarrësit në mënyrë që të sigurohet se pagesat janë duke u kryer brenda afateve të parapara kohore, në të kundërtën të marrin masa për ndërprerjen e kontratave përkatëse.

#### Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

## 2.2 Çështjet tjera të menaxhimit financiar dhe të pajtueshmërisë

### 2.2.1 Të hyrat nga shitja e aseteve

Gjatë vitit 2024, janë realizuar të hyra nga shitja e aseteve në vlerë prej 17,370,921€. Këto të hyra janë nga pagesat e pranuar lidhur me shitjen e aseteve të tenderuar përmes valëve të privatizimit, pranimet nga shpronësimet, shitja e aseteve përmes metodës të negocimit direkt si dhe të hyrat nga bartja e të drejtës banesore.

#### Çështja A1 - Mos respektimi i afatit kohor për shqyrtimin e kërkesave të shitjeve me negocim direkt

##### Gjetja

Sipas nenit 8, pika 1 e Rregullores nr. 16/2023 për shitjen direkte të aseteve, përcakton se "Nga dita e regjistrimit të kërkesës, Agjencia ka për detyrë që brenda 1 (një) muaji ta fillojë procedurën e shqyrtimit e cila në varësi të veprimeve, numrit të palëve dhe aspekteve tjera, mund të zgjasë deri në 3 (tre) muaj. Po ashtu, neni 6, pika 2 e kësaj rregullore përcakton se, shqyrtimi i kërkesave për shitje direkte bazohet në rendin kronologjik sipas datës së ushtrimit të kërkesës, përjashtimisht do të merren në shqyrtim kërkesat të cilat janë të kompletuara (për të evituar vonesat e panevojshme dhe grumbullimin e lëndëve).

Tutje, pas shqyrtimit preliminar nga njësia për shitje direkte, në rastet kur aset i lëndor që është objekt i kërkesës ka elemente të asetit me karakter specifik, kërkesa së bashku me provat përcjellëse kalon tek Autoriteti i Likuidimit dhe se brenda 15 ditëve kalendarike obligohet ti përgjigjet me shkrim/postë elektronike duke dhënë pëlqimin apo mos pëlqimin se aset i ka bazë për iniciimin e procedurës së shitjes direkte.

Gjatë testimit të procedurës së shitjes me negocim direkt, në 3 (tre) raste kërkesat e blerësve që ishin bërë në vitin 2024, 2019 dhe 2016 ishin shqyrtuar brenda gjatë vitit 2024, duke anashkaluar kërkesat më të vjetra që presin për shqyrtim që nga vitit 2011. Tutje, gjatë vitit 2024 ishin gjithsej 288 palë që kanë parashtruar kërkesë për blerje të aseteve. Prej tyre janë aprovuar 28, janë refuzuar 60, përderisa 200 të tjera janë në proces dhe presin për shqyrtim. Përveç kërkesave të vitit 2024, gjithsej ishin trajtuar 584 raste duke i përfshirë edhe ato të viteve paraprake.

Gjatë analizës së bazës së të dhënave për shitjet me negocim direkt, vërejmë se numri i kërkesave për blerje të aseteve (tokë, objekt) të bëra nga palët mbetet shumë i lartë. Sipas shënimeve të ofruara nga zyrtarët përgjegjës të AKP-së dhe nga regjistri i përgjithshëm i parashtrueseve të kërkesës, deri në dhjetor 2024 ishin 1,655 kërkesa të pashqyrtuara. Kjo tregon për një pritje të stërzgjatur, të kërkesave që presin për shqyrtim.

Lidhur me këto, AKP me datën 30.09.2024 kishte ndryshuar rregulloren ekzistuese dhe aprovuar rregulloren e re Nr. 04/2024 për shitjen direkte të aseteve të caktuara të ndërmarrjeve shoqërore. Në nenin 12 paragrafi 1 i Rregullores Nr. 04/2024 për Shitjen Direkte është përcaktuar se: *"Nga dita e regjistrimit të kërkesës, Agjencia ka për detyrë që brenda një afati optimal kohorë ta fillojë procedurën e shqyrtimit e cila do të përcaktohet në varësi*

*të veprimeve, numrit të palëve dhe aspekteve dhe rrethanave tjera në Divizion”, duke e larguar afatin deri në 3 (tre) muaj për shqyrtimin e tyre siç ishte në nenin 8 të rregullores paraprahe.*

Sipas zyrtarëve, me rregulloren e brendshme të AKP-së për shitje direkte, mos shqyrtimi i kërkesave sipas rendit kronologjik lejohet për rastet e kërkesave që ishin të kompletuara ndaj atyre të pakompletuara. Megjithatë gjatë testimeve tona ne nuk kemi vërejtur arsyetime se pse i janë dhënë prioritet disa kërkesave ndaj të tjerave.

#### **Ndikimi**

Mosrespektimi i rendit kronologjik pa arsyetim të dokumentuar, dhe mungesa e transparencës në përzgjedhjen e kërkesave për shqyrtim si dhe ndryshimi i afatit kohor nga 3 muaj në afat optimal mund të ndikojë ka ndikuar në trajtim të pabarabartë të palëve si dhe që shumë lëndë të mos trajtohen për vite të tëra. Kjo mund të ndikojë në uljen e besueshmërisë së procesit të shitjes direkte.

#### **Rekomandimi A1**

Bordi i Drejtorëve duhet të sigurohet që shqyrtimi i kërkesave për shitje direkte të bëhet në përputhje me brenda një afati të caktuar kohor afatet e përcaktuara me rregullore dhe se përzgjedhja e tyre për shqyrtim, jashtë rendit kronologjik duhet të bëhet vetëm në raste të dokumentuara qartë, duke siguruar transparencë dhe trajtim të barabartë për të gjitha palët aplikuese.

#### **Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)**

## 2.2.2 Të arkëtueshmet

Vlera e llogarive të arkëtueshme nga shitja e aseteve e prezantuar në PFV për vitin 2024 ishte 8,171,724€. Llogaritë e arkëtueshme kanë të bëjnë me vlerën financiare të pa arkëtuar nga valët e privatizimit/likuidimit, shitjeve përmes negocimit direkt dhe qiratë apo të hyra të tjera nga asetet e NSH-ve.

### Çështja A2 - Mbivlerësim i llogarive të arkëtueshme nga qiratë

#### Gjetja

Neni 9 i Rregullores për Kornizën Raportuese të Pasqyrave Financiare të Fondeve në Mirëbesim, e miratuar nga Bordi i Drejtorëve më datë 23.02.2021 parasheh që në shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare duhet të paraqiten të ardhurat e arkëtueshme.

Gjatë testimit të llogarive të arkëtueshme të lidhur me të hyrat nga qiratë, janë identifikuar gabime që kanë ndikuar në saktësinë e prezantimit të tyre në pasqyrat financiare, si:

- Në dy (2) raste, faturat për muajin janar 2025 ishin regjistruar gabimisht në shumën prej 61,537€ në regjistrin e llogarive të arkëtueshme të periudhës aktuale të raportimit. Ndërsa do të duhej të regjistroheshin në shumën prej 33,916€ duke rezultuar në një mbivlerësim prej 27,621€ të llogarive të arkëtueshme; dhe
- Në dy (2) raste tjera, vlera e paraqitur në shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare për llogaritë e arkëtueshme ishte në shumën prej 63,177€, ndërkohë që vlera reale sipas vendimit final nga gjykata ishte 11,222€ duke mbivlerësuar llogaritë e arkëtueshme në shumën prej 51,955€.

Të gjitha këto gabime kishin çuar në mbivlerësim të llogarive të arkëtueshme në shumën prej 79,576€.

Kjo kishte ndodhur për shkak të mos funksionimit të kontrolleve të brendshme lidhur me harmonizimin dhe mbajtjen e saktë të regjistrit të llogarive të arkëtueshme. Lidhur me këtë, në vitin 2025 AKP ishte në proces të blerjes së një softueri, i cili sipas tyre do të eliminojë këto dobësi.

#### Ndikimi

Gabimet e evidentuara në paraqitjen e llogarive të arkëtueshme kanë ndikuar në paraqitjen jo të saktë të informatave në PFV. Kjo mund të ndikojë negativisht në vlerësimin e performancës financiare të agjencisë.

#### Rekomandimi A2

Bordi i Drejtorëve duhet të përmirësoj kontrollet lidhur me regjistrimin e llogarive të arkëtueshme, për të siguruar se ato regjistrohen dhe raportohen saktë në përputhje me dokumentacionin mbështetës, në mënyrë që prezantimi i tyre në PFV të jetë i saktë dhe i plotë.

### Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

### 2.2.3 Detyrimet kontigjente

Vlera e paraqitur në PFV për detyrimet kontigjente për vitin 2024 ishte 5,319,078€ duke shënuar një rënie prej 2,114,902€ krahasuar me vitin paraprak, ku vlera ishte 7,443,980€. Kjo rënie vlerës vjen si rezultat i rasteve të fituara nga ana e AKP-së gjatë vitit 2024.

#### Çështja A3 - Shpalosje jo e saktë e detyrimeve kontingjente në shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare

|                       |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                           |
|-----------------------|-------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| <b>Gjetja</b>         | Neni 9 i Rregullores për Kornizën Raportuese të Pasqyrave Financiare të Fondeve në Mirëbesim të miratuar nga Bordi i Drejtorëve më datë 23.02.2011 parasheh që në shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare duhet të paraqiten detyrimet kontingjente.                                                                                                                                  |
|                       | Gjatë auditimit të detyrimeve kontigjente, kemi vërejtur se në një (1) rast edhe pse ishte dhënë aktgjykimi final nga Gjykata sipas të cilit urdhërohej AKP që palës paditëse t'i kompensojë shumën prej 122,994€, AKP kishte vazhduar t'a paraqesë këtë shumë në shpalosjet e detyrimeve kontingjente duke çuar kështu në mbivlerësim të tyre në shumën prej 122,994€.                   |
|                       | Kjo kishte ndodhur si pasojë e mos azhurnimit me kohë të regjistrit të detyrimeve kontigjente. Sipas zyrtarëve të Agjencisë, nuk është ekzekutuar ende pagesa për shumën kryesore prej 122,994 euro pasi që nuk është parashtruar kërkesë nga pala paditëse ose avokati i autorizuar prej tij, prandaj kishin vazhduar t'a prezantonin këtë lëndë në regjistrin e detyrimeve kontigjente. |
| <b>Ndikimi</b>        | Mos azhurnimi me kohë i regjistrit të detyrimeve kontingjente ka ndikuar në paraqitje jo të saktë të vlerës së tyre, duke rezultuar me mbivlerësim të detyrimeve kontigjente në shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare.                                                                                                                                                              |
| <b>Rekomandimi A3</b> | Bordi i Drejtorëve duhet të sigurohet se regjistri i detyrimeve kontingjente të azhurnohet në kohë, në mënyrë që çdo informacioni i ri të reflektohet saktë dhe në kohë në pasqyrat financiare.                                                                                                                                                                                           |

#### Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

### 3 Informacion i përmbledhur për pranimet dhe pagesat e Fondeve në Mirëbesim

Ne i kemi shqyrtuar burimet e fondeve buxhetore dhe shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike. Kjo është paraqitur në tabelën e mëposhtme;


**Tabela 1. Pasqyra e pranimeve dhe pagesave për vitet 2023 dhe 2024 në Euro (€)**

| Përshkrimi                                                                 | Pranimet/Pagesat Janar-Dhjetor 2023 | Gjendja e llogarive me 31 dhjetor 2023 | Pranimet/Pagesat Janar-Dhjetor 2024 | Gjendja e llogarive me 31 dhjetor 2024 |
|----------------------------------------------------------------------------|-------------------------------------|----------------------------------------|-------------------------------------|----------------------------------------|
| <b>PRANIMET NË LLOGARITË BANKARE</b>                                       |                                     |                                        |                                     |                                        |
| <b>Gjithsej PRANIMET NË LLOGARITË BANKARE</b>                              | <b>10,743,398</b>                   | <b>22,242,072</b>                      | <b>23,957,418</b>                   | <b>46,199,490</b>                      |
| Të hyrat nga shitja e aseteve                                              | 5,408,810                           | 11,560,870                             | 17,370,921                          | 28,931,790                             |
| Të hyrat nga qiraja                                                        | 5,310,881                           | 10,153,160                             | 5,519,944                           | 15,673,104                             |
| Interesi i fituar                                                          | 312,448                             | 312,448                                | 517,127                             | 829,575                                |
| Të hyrat nga tarifa dhe konfiskimet e Bid Depozitave në tenderët e shitjes | 36,200                              | 147,701                                | 159,500                             | 307,201                                |
| Bid depozitat për Pjesëmarrje në Tender                                    | -89,500                             | 121,500                                | 208,500                             | 330,000                                |
| Të hyra tjera                                                              | -235,440                            | -53,606                                | 181,427                             | 127,821                                |
| Kapitali themeltar i Agjencisë Kosovare të Privatizimit                    | 0                                   | 0                                      | 0                                   | 0                                      |
| <b>PAGESAT/SHPËRNDARJA NGA LLOGARITË</b>                                   |                                     |                                        |                                     |                                        |
| <b>Gjithsej PAGESAT/SHPËRNDARJA NGA LLOGARITË</b>                          | <b>10,224,136</b>                   | <b>40,605,444</b>                      | <b>11,187,885</b>                   | <b>51,793,330</b>                      |
| 20% i punëtorëve transferuar në BSPK                                       | 3,229,677                           | 9,903,504                              | 3,445,372                           | 13,348,877                             |
| Ofruesi i Shërbimeve Profesionale (Autoritetet e Likuidimit)               | 499,800                             | 929,700                                | 499,800                             | 1,429,500                              |
| Mallra dhe shërbime                                                        | 1,660,991                           | 3,461,544                              | 1,792,552                           | 5,254,095                              |
| Shpenzimet komunale                                                        | 178,674                             | 385,510                                | 105,587                             | 491,097                                |
| Tatimet                                                                    | 764,646                             | 1,583,744                              | 750,623                             | 2,334,367                              |
| Vendimet e gjykatave/përmbauesve (depozita dhe taksa)                      | 47,226                              | 5,413,858                              | 89,028                              | 5,502,886                              |
| Transferimi i mjeteve 5% për mbulimin e aktiviteteve të AKP-së             | 0                                   | 0                                      | 0                                   | 0                                      |
| Të tjera                                                                   | 12,393                              | 25,871                                 | 7,098                               | 32,969                                 |
| Pagesat ndaj kreditorëve të NSh-së                                         | 3,830,728                           | 18,901,713                             | 4,746,620                           | 23,648,333                             |
| Fondet transferuar Buxhetit të Kosovës                                     | 0                                   | 0                                      | -248,794                            | -248,794                               |
| <b>Gjendja bankare</b>                                                     | <b>519,263</b>                      | <b>-18,363,372</b>                     | <b>12,769,533</b>                   | <b>-5,593,839</b>                      |


Gjatë vitit 2024 pranimet apo të hyrat ishin 23,957,419€, që paraqet një rritje prej 123% krahasuar me vitin e kaluar. Këto të hyra kanë të bëjnë me shitjet, qiratë e aseteve të NSh-ve dhe të hyrave tjera.

Ndërsa, pagesat apo shpërndarjet gjatë vitit 2024 ishin në vlerë prej 11,187,887€, krahasuar me 10,224,135€ në vitin 2023. Kjo rritje ishte si rezultat i shpërndarjeve më të larta të pagesave për 20% të punëtorëve të transferuar në BSPK, si dhe pagesave ndaj kreditorëve të NSh-ve, të cilat u realizuan në masë më të madhe gjatë vitit 2024.

Grafiku 1. Pranimet sipas kategorive ekonomike gjatë periudhës 2023-2024



Grafiku 2. Pagesat sipas kategorive ekonomike gjatë periudhës 2023-2024



## 4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Raporti i auditimit për PFV-të të vitit 2023 të Fondeve në Mirëbesim ka rezultuar me katër (4) rekomandime. FM kishte përgatitur një Plan Veprimi ku paraqitet mënyra se si do t'i zbatoj rekomandimet e dhëna.

Deri në fund të auditimit tonë për vitin 2024, tre (3) rekomandime ishin zbatuar, ndërsa një (1) rekomandim nuk ishte zbatuar ende. Për një përshkrim më të plotë të rekomandimeve dhe mënyrën se si janë trajtuar ato, shihni në Tabelën 4 (ose Tabelën e rekomandimeve).

**Grafiku 3. Progresi në zbatimin e rekomandimeve të vitit paraprak**




Tabela 4. Përmbledhja e rekomandimeve të vitit paraprak

| Nr | Fusha e Auditimit             | Rekomandimet e vitit 2023                                                                                                                                                                                                   | Veprimet e ndërmarra                                                                                                | Statusi                 |
|----|-------------------------------|-----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|---------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|-------------------------|
| 1. | Të hyrat                      | Bordi i Drejtorëve duhet të shtojë kontrollin tek qiramarrësit në mënyrë që të sigurohet se pagesat janë duke u kryer brenda afateve të parapara kohore.                                                                    | Raste të ngjashme përsëriten edhe gjatë vitit 2024 në kategorinë e të hyrave/llogarive të arkëtueshme. Referenca B1 | Nuk ka filluar zbatimin |
| 2. | Të hyrat nga shitja e aseteve | Bordi i Drejtorëve duhet të shtojë kontrollin e brendshëm lidhur me arkëtimin e të hyrave nga shitja e aseteve me negociim direkt si dhe të ndërmarrë veprimet e duhura në rastet kur pagesat nuk arkëtohen brenda afateve. | Janë ndërmarrë veprime për adresim të rekomandimit.                                                                 | I zbatuar               |
| 3. | Mallra dhe shërbime           | Bordi i Drejtorëve duhet të sigurojë që përmes komisioneve përkatëse të përzgjedhë kandidatët të cilët plotësojnë kriteret e përcaktuara në konkurset e shpallura publike.                                                  | Gjatë testimit është konfirmuar se nuk ka pasur raste të ngjashme.                                                  | I zbatuar               |
| 4. | Shpenzimet komunale           | Bordi i Drejtorëve duhet të sigurojë që të gjitha faturat të paguhen brenda afateve kohore ligjore me qëllim të mos dëmtimit të buxhetit të AKP-së me kosto tjera shtesë përmbartimore.                                     | Gjatë testimit është konfirmuar se nuk ka pasur raste të ngjashme.                                                  | I zbatuar               |

Vlora Spanca, Auditore e Përgjithshme



Shkelqim Xhema, Drejtor i Auditimit



Vlora Duraku, Udhëheqëse e ekipit



Egzona Maqedonci, Anëtare e ekipit



Jehona Krasniqi, Anëtare e ekipit



## Shtojca I: Letër konfirmimi

|                                                                       |                  |
|-----------------------------------------------------------------------|------------------|
| REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO           |                  |
| AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT - KOSOVSKA AGENCIJA ZA PRIVATIZACIJU |                  |
| PRIVATISATION AGENCY OF KOSOVO                                        |                  |
| II                                                                    |                  |
| Nr. Br. 2539                                                          |                  |
| Nr. f. 1                                                              | Data: 28.05.2025 |
| Nr. Str. 1                                                            |                  |
| Nr. pg. 1                                                             |                  |
| Prishtinë / Pristina                                                  |                  |

AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT  
KOSOVSKA AGENCIJA ZA PRIVATIZACIJU  
PRIVATISATION AGENCY OF KOSOVO

### LETËR E KONFIRMIMIT

Për pajtueshmërinë me gjetjet e Auditorit të Përgjithshëm për vitin 2024 dhe për zbatimin e rekomandimeve.

Për: **Vlora Spanca**  
Auditore e Përgjithshme  
Zyra Kombëtare e Auditimit

|                                                             |                |
|-------------------------------------------------------------|----------------|
| REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO |                |
| ZYRA KOMBËTARE E AUDITIMIT                                  |                |
| NACIONALNA KANCELARIJA REVIZIJE / NATIONAL AUDIT OFFICE     |                |
| DATE: 28-05-2025                                            |                |
| Nr. Org. 05                                                 | Nr. Prot. 47   |
| Nr. Jedin. 811                                              | Nr. Stranica 1 |
| Nr. Klasif. 1                                               | Nr. Klasif. 1  |
| Nr. Kod. 1                                                  | Nr. Kod. 1     |
| Nr. Klasif. 1                                               | Nr. Klasif. 1  |
| Nr. Kod. 1                                                  | Nr. Kod. 1     |

E nderuar znj. Spanca,

Përmes kësaj shkrese, konfirmoj se:

- kam pranuar draft raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit për auditimin e pasqyrave financiare vjetore të Fondeve në Mirëbesim, për vitin 2024 (në tekstin e mëtejshëm "Raporti");
- pajtohem me gjetjet dhe rekomandimet dhe nuk kam ndonjë koment për përmbajtjen e Raportit.
- brenda 30 ditëve nga pranimi i Raportit final, do t'ju dorëzoj një plan të veprimit për zbatimin e rekomandimeve, i cili do të përfshijë afatet kohore dhe stafin përgjegjës për zbatimin e tyre.

Me respekt,  
  
**Ibrahim Gjylenderen**  
u.d. Drejtor Ekzekutiv  
Agjencia Kosovare e Privatizimit

Data 28 maj 2025

Tel: +383 (0) 38 500 400  
Faks: +383 (0) 38 248 076

Email: [info@pak-ks.org](mailto:info@pak-ks.org)  
[www.pak-ks.org](http://www.pak-ks.org)

Rr. Driton Hoxha, 55, Lakrishtë  
10000 Prishtinë, Republika e Kosovës

## Shtojca II: Shpjegim lidhur me llojet e të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA dhe pjesëve të tjera të Raportit të Auditimit

Raporti i auditorit për pasqyrat financiare<sup>6</sup> duhet të përmbajë një opinion për pasqyrat financiare, bazuar në përfundimet e nxjerra nga dëshmitë e marra gjatë auditimit. Kur auditimi kryhet për të vlerësuar gjithashtu përputhjen me legjislacionin dhe rregulloret e tjera, auditorët kanë një përgjegjësi shtesë për të raportuar për pajtueshmërinë me autoritetet<sup>7</sup>, duke rezultuar me konkluzion mbi pajtueshmërinë.

Për të arritur në përfundimin se një opinion mbi pasqyrat financiare është i modifikuar ose i pa modifikuar, një auditor duhet të sigurohet që rezultatet e auditimit përfshijnë, apo jo, keq-deklarim (e) material(e) ose të përhapur(a), apo të tillë(a) të mundshëm(me), të supozuar në rast kufizimi të fushëveprimit.

Keq-deklarimi është një ndryshim mes shumës së raportuar, klasifikimit, prezantimit ose zbulimit të një zëri të pasqyrës financiare dhe sasisë, klasifikimit, prezantimit ose zbulimit që kërkohet që zëri të jetë në përputhje me kornizën e raportimit financiar në fuqi. Keq-deklarimet mund të vijnë nga gabimi ose mashtrimi.

(shkëputur nga SNISA 200)

### Forma e opinionit

#### Opinion i pa-modifikuar

Formulohet kur nuk janë zbuluar keq-deklarime ose mos-pajtueshmëri; kur janë zbuluar keq-deklarime ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, por që nuk është i barabartë me ose nuk e tejkalon nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimi(et) dhe/ose mos-pajtueshmëria e zbuluar brenda një klase të caktuar transaksionesh nuk është e barabartë me ose e tejkalon nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve. Formulohet gjithashtu nëse nuk ka kufizim të fushëveprimit ose kur kufizimi i fushëveprimit nuk mund të shpie në shmangie të keq-deklarimit(eve) material(e) dhe/ose mos-pajtueshmërisë(ve).

Kufizimi i fushëveprimit ndodh kur një auditor nuk është në gjendje të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të arritur në përfundimin se pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale.

Auditori duhet të japë **opinion të pa-modifikuar** nëse arrin në përfundimin se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

**Modifikimi i opinionit në raportin e auditorit**

Auditori duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit nëse konstatohet se, bazuar në dëshmitë e marra nga auditimi, pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale dhe/ose mos-pajtueshmëri, ose nuk është në gjendje të sigurojë prova të mjaftueshme të auditimit për të arritur në përfundimin se pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale dhe/ose mos-pajtueshmëri..

Opinionit i modifikuar mund të jetë:

- I kualifikuar,
- I kundërt, ose
- Mohim opinionit

**Opinionit i kualifikuar**

Formulohet kur janë zbuluar keq-deklarime dhe/ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, që janë të barabartë me ose e tejkalojnë nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimi dhe/ose mos-pajtueshmëria e zbuluar brenda një klase të caktuar transaksionesh është i barabartë me ose tejkalon nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve. Formulohet gjithashtu nëse ka kufizim të fushëveprimit, i cili mund të mos shpie në shmangie të keq-deklarimit(eve) material(e).

**Opinion i kundërt**

Formulohet kur janë zbuluar keq-deklarime dhe/ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, që tejkalon në mënyrë të përhapur nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimet dhe/ose mos-pajtueshmëritë e zbuluara brenda një klase të caktuar transaksionesh e tejkalojnë në mënyrë të përhapur nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve.

“E përhapur” është term që përdoret, në kontekstin e keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërive, për të përshkruar efektet e keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërisë në pasqyrat financiare; ose efektet e mundshme në pasqyrat financiare të keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërisë, nëse ka të tilla, që nuk zbulohen për shkak të pamundësisë për të marrë dëshmi të mjaftueshme e të duhura të auditimit. Efektet e përhapura në pasqyrat financiare janë ato që, sipas gjykimit të auditorit::

- a) Nuk kufizohen vetëm në elemente, llogari ose zëra të veçantë të pasqyrave financiare;
- b) Por nëse kufizohen si të tilla, përfaqësojnë ose mund të përfaqësojnë një pjesë të konsiderueshme të pasqyrave financiare; ose
- c) Për sa i përket shpalosjeve, janë thelbësore që përdoruesit të kuptojnë pasqyrat financiare.

**Mohim i opinionit**

Formulohet kur kufizimi i fushëveprimit, d.m.th. kur pamundësia për të siguruar prova të mjaftueshme të përshtatshme të auditimit, është i natyrës materiale dhe pervazive.

**Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit**

Nëse auditori e konsideron të nevojshme të tërheqë vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë pasqyrat financiare, por ka dëshmi të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban keq-deklarime materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë paragrafin e Theksimit të çështjes në raportin e tij. Paragrafi për Theksimin e Çështjes duhet t'i referohet vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare.

Paragrafi i theksimit të çështjes duhet:

- të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- të ketë titullin 'theksim i çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç'pjesë të pasqyrave financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen; dhe
- të tregojë se opinionit i auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

Nëse auditori e konsideron të nevojshme të komunikojë një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që të kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje të tjera", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të çështjes.

## Shënimet fundore

- <sup>1</sup> Pajtueshmëria me autoritetet - pajtueshmëria me të gjitha ligjet, rregullat, rregulloret, standardet dhe praktikat e mira relevante në sektorin publik
- <sup>2</sup> Raportet tjera janë kërkesë e nenit 8 të së Rregullores 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar
- <sup>3</sup> Kolektivisht të referuara si pajtueshmëri me autoritetet
- <sup>4</sup> Çështja A dhe Rekomandimi A - nënkupton çështjet dhe rekomandimet e reja  
Çështja B dhe Rekomandimi B - nënkupton çështjet dhe rekomandimet e përsëritura  
Çështja C dhe Rekomandimi C- nënkupton çështjet dhe rekomandimet pjesërisht të përsëritura.
- <sup>5</sup> Buxheti Final - buxheti i aprovuar nga Kuvendi i përshtatur më pas nga Ministria e Financave
- <sup>6</sup> Pasqyrat financiare në sektorin publik përfshijnë po ashtu edhe pasqyrën(at) e ekzekutimit të buxhetit
- <sup>7</sup> Pajtueshmëria me autoritetet: pajtueshmëria me ligjet, rregulloret, standardet, apo praktikat e mira.